



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2020:075365

Datë: 14.12.2020

Numri i dokumentit: 01340975

P.nr.397/20

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin e vetëm gjykues Rilind Sermaxhaj, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Eronita Llapashtica, në çështjen penale kundër të pandehurve Sh. R nga ...dhe D.R nga fshati ..., Komuna e ..., për shkak të veprës penale posedimi i pa autorizuar i narkotikëve i substancave psikotropike ose analoge nga neni 269 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-ës, duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan me numër PP.II.nr.947/2020, të datës 24.06.2020, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar dhe pranimit të fajësisë nga ana e të pandehurve, mori dhe publikisht me datën 08.12.2020 shpalli këtë:

AKTGJYKIM

Të pandehurit:

Sh. R, nga babai G... dhe nëna F..., e lindur K..., i lindur me datë ..., në ..., ku dhe jeton, rruga "...", numër 224, i pa martuar, i papunësuar, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës dhe

D. R nga babai F..., dhe nëna H..., e lindur M..., i lindur me datë ..., në ..., ndërsa me vendbanim në fshatin ..., Komuna e ..., i pa martuar, i pa punësuar, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,

JANË FAJTOR

Sepse me datë 29.04.2020, rreth orës 12:30 minuta, në ... në rrugën "...", të pandehurit pa autorizim kanë poseduar substancë narkotike, në atë mënyrë që derisa kishin qenë në banesën e të pandehurit D..., kishin tymosur nga një gjoint cigare, e më pas ishin alivanosur, e në momentin që shkojnë policia në banesën e lartcekur gjejnë substancë narkotike në sasi prej 1.3 gram e cila substancë pas bërjes së testit fushor ka rezultuar të jetë e llojit "Marihuanë".

-Me çka kanë kryer veprën penale, posedim i pa autorizuar i narkotikëve i substancave psikotropike ose analoge nga neni 269 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-ës.

Andaj gjykata në bazë të nenit 4,38,39,46,47,48,49,69,70,71 dhe 72 të KPRK-ës dhe neneve 248 e 365 të KPP-ës, të pandehurit Sh..dhe D.R secilin prej tyre veç e veç:

I GJYKON

Me dënim me gjobë në shumë prej nga 200 € (dyqind euro), të cilat të pandehurit e lartcekur obligohen ti paguajnë në afat prej 15 ditëve nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë si dhe me dënim me burgim në kohëzgjatje prej nga 150 (njëqindpesëdhjetë) ditëve, të cilat dënime nuk do të ekzekutohen nëse të pandehurit në periudhën verifikuese prej 1 (një) viti nuk kryejnë ndonjë vepër tjetër penale.

Nëse të pandehurit nuk dëshirojnë, nuk mundën ose nuk janë në gjendje ta paguajnë dënimet me gjobë atëherë dënimet me gjobë do t'iu zëvendësohen në dënim me burgim në atë mënyrë që për çdo 20 € (njëzet euro) do t'iu caktohet nga një ditë burgim.

Po ashtu në bazë 269 paragrafi 3 të KPRK-ës nga të pandehurit e lartcekur KONFISKOHET substanca narkotike e llojit “Marihuanë”, në peshë 1.3 gram, e cila pasi ky aktgjykim të merr formën e prerë duhet të shkatërrohet nga ana e komisionit të formuar nga kryetari i kësaj gjykate-sektori për ekzekutimin e sanksioneve penale të cilët duhet te përpilojnë procesverbal për shkatërrimin e sendit të konfiskuar dhe të njëjtin duhet t'ia bashkëngjisin lëndës përkatëse.

Obligohen të pandehurit e lartcekur që secili prej tyre veç e veç të paguajnë paushallin gjyqësor në shumën prej nga 30 € (tridhjetë euro) si dhe shumën prej nga 30 € (tridhjetë euro) për kompensimin e viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

ARSYETIM

1.Rrjedha e çështjes

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, me datë 25.06.2020, ka ngritur aktakuzën me numër PP.II.nr.947/2020, kundër të pandehurve Sh.R nga dhe D. R nga fshati ..., Komuna e ..., për shkak të veprës penale posedimi i pa autorizuar i narkotikëve i substancave psikotropike ose analoge nga neni 269 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-ës.

Më datë 08.12.2020, në këtë gjykatë është mbajtur seanca e shqyrtimit fillestar në të cilën ish-in prezent prokurori i shtetit Shefik Mehmeti dhe të pandehurit Sh... dhe D.R. Në këtë seancë i pandehuri pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit secili prej të pandehurve veç e veç kanë deklaruar se e kanë kuptuar në tërësi aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohen dhe se e pranojnë fajësinë për kryerjen e veprës penale e cila iu vihet në barrë me ç'rast gjykata pas dëgjimit të palëve dhe në pajtim me nenin 248 paragrafi 1 të KPP-ës, ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë nga ana e të pandehurve.

2.Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Gjykata pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar në të cilin kanë qenë prezent prokurori i shtetit dhe të pandehurit e lartcekur si dhe pas dëgjimit të palëve ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë e të pandehurit për veprën penale për të cilën akuzohet ngase ka konstatuar se janë plotësuar gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë si në kuptim të nenit 248 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4 të KPRK-së. Në këtë aspekt gjykata ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar drejtë natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht, dhe se të pandehurit nuk kanë qenë të detyruar ose të shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojnë fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes të cilat i përmban aktakuza siç janë: raporti fillestar i incidentit me numër të rastit 2020-DHTN-242, i datës 29.04.2020, raporti i shpejtë, memorandum i zyrtar i datës 29.04.2020, deklaratat e të pandehurve Sh... dhe D. R të dhëna me datë 30.04.2020, vërtetimi mbi sekuestrimin e sendeve i datës 29.04.2020, e kaluar kriminale e të pandehurve, raporti njoftues lidhur me rastin 2020-DHTN-...për testin fushor, raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes, foto dokumentacioni si dhe shkresat e bashkangjitura në lëndë dhe se gjykata po ashtu me rastin e pranimi të fajësisë nga ana e të pandehurve ka konstatuar se aktakuza lëndore nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

3.Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në të lartcekurat, gjyqtari i vetëm gjykues vërtetoi këtë gjendje faktike: se i pandehurit Sh. R dhe D. R kanë kryer veprën penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

4.Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata me rastin e matjes së dënimit ka vlerësuar që secili prej të pandehurve veç e veç duhet t'iu shqiptohen dënimet si në dispozitiv të këtij aktgjykimi ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ky dënim do të jetë i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësinë penale të kryesit gjithashtu gjykata me rastin e matjes së dënimit ka marrë për bazë edhe rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit duke u bazuar në nenet 69,70,71 dhe 72 të KPRK-së, ashtu që si rrethanë lehtësuese për të pandehurit ka marrë faktin se të njëjtit kanë pranuar fajësinë për kryerjen e veprës penale e cila iu vihet në barrë në një fazë të hershme të procedurës penale përkatësisht të njëjtit fajësinë për kryerjen e kësaj vepre e kanë bërë në çdo fazë të procedurës, të njëjtit janë penduar dhe kanë shfaqur keqardhje për veprimet e tyre, kanë kërkuar falje për këto veprime, po ashtu gjykata mori parasysh faktin se të njëjtit kanë premtuar që në të ardhmen nuk do të kryejnë vepra të tilla dhe as vepra të tjera penale, ndërsa si rrethanë rënduese për të pandehurit gjykata mori parasysh dashjen e shfaqur nga ana e tyre meqenëse të njëjtit nga përshkrimi i veprimeve inkriminuese del se kanë qenë të vetëdijshëm se një veprim i tillë është i ndaluar mirëpo përkundër kësaj të njëjtit kanë ndërmarr veprimet përkatësisht kanë marrë substancën narkotike të llojit marihuanë, kanë shkuar në banesën e të pandehurit D... ku edhe e kanë konsumuar derisa edhe e kanë humbur vetëdijen nga konsumimi i saj. Gjykata me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit me gjobë konsideron se me

lartësinë e dënimit me gjobë të njëjtëve por familjarëve të tyre nuk iu rrezikohet mirëqenia e tyre ekonomike andaj duke u bazuar në të lartcekurat gjykata konsideron se me dënimet e shqiptuara ndaj të pandehurve mund të arrihen qëllimet e dënimit si në kuptim të nenit 38 të KPRK-ës të cilat konsistojnë në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tij, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehjen e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

5. Vendimi mbi konfiskimin e substancës narkotike.

Gjykata duke vepruar sipas propozimit të prokurorit të shtetit si dhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 269 paragrafi 3 të KPRK-ës nga të pandehurit Sh... dhe D. R ka konfiskuar substancën narkotike e llojit “Marihuanë”, në sasi prej 1.3 gram.

6. Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Duke pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të të pandehurve, gjykata duke u bazuar në nenin 451 paragrafi 1 të KPP-së, ka vendosur që të pandehurit secilin prej tyre veç e veç ti detyrojë të paguajnë paushallin gjyqësor në shumë prej nga 30 € (tridhjetë euro) si shumë prej nga 30 € (tridhjetë euro) për kompensimin e viktimave të krimit, në afat prej 15 ditëve nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë.

Andaj duke u bazuar në të lartcekura gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN

Departamenti i Përgjithshëm

P.nr.397/2020, me datë 08.12.2020

Zyrtare ligjore,
Eronita Llapashtica

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Rilind Sermaxhaj

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet kësaj Gjykate Themelore.